



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M
Nr.1393, datë 27.09.2010

Për
“Miratimin e Termave të Pergjithshme të Kontrates (Kontrate Tip) së Plus Communication sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të levizshme”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 27.09.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimi i kontratës tip për pajtimtarin të sipërmarrësit Plus Communication sh.a. për shërbimin e telefonisë publike të levizshme.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 5, neni 99 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr.9902, date 17.04.2008 “Per mbrojtjen e konsumatoreve”(Ligj nr.9902);
3. Ligji nr.9987, date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e të dhënave personale”(ligji nr.9987)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Plus Communication sh.a, me shkresen nr.437 prot, date 06.07.2010 “*Kerkese per miratimin e kushteve te pergjithshme te kontrates me pajtimtarit me paspagese*”, ka depozituar modelin e Kontratës Tip të Pajtimtarit per sherbimin publik telefonik te levizshem.
2. Pas shqyrtimit te kontrates tip te pajtimtarit te derguar nga Plus Communication sh.a, u konstatuan mangesi ne hartimin e saj. Per kete arsye me shkrese nr.2850/1 date 05.08.2010 “*Mbi draft kontraten tip te pajtimtarit per sherbimin publik te telefonise se levizshme*”, iu sugjerua Plus Communication sh.a te rishikoje hartimin e kushteve te pergjithshme te kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
3. Plus Communication sh.a, me shkresen nr.629 prot, date 13.09.2010 “*Kerkese per miratimin e kontrates tip te pajtimtarit*”, ka ridepozituar modelin e Kontratës Tip të Pajtimtarit per sherbimin publik telefonik te levizshem, duke reflektuar sugjerimet e bera nga AKEP.
4. AKEP, me qellimin e mbrojtjes sa me te mire te konsumatorit, bazuar ne:
 - a. Qellimin e garantimit te sherbimeve te duhura dhe te pershtatshme ne Shqiperi, te shprehur ne nenin 1 te ligjit nr.9918, dhe
 - b. Objektivat rregullatore per mbrojtjen e interesave te perdoruesve te sherbimeve te komunikimeve elektronike, te shprehur ne germat ‘a’ dhe ‘b’, pika 3, neni 7 i ligjit 9918.ka gjykuar si te nevojshme imponimin e ndryshimeve ne draft-kontraten e Plus Communication sh.a, te depozituar me shkresen nr.629 prot, date 13.09.2010.
5. Ndryshimet e bëra nga AKEP të Kontratës së Plus Communication sh.a, kanë marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 9918, ligjit nr. 9902, praktikave më të mira rregullatore per mbrojtjen e konsumatorit ne Shqiperi, vendet e BE dhe te rajonit.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për sipërmarrësin dhe per mbrojtjen e interesave te konsumatoreve, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendshme te AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë Termat e Pergjithshme te Kontrates (Kontrata Tip) te sipermarresit Plus Communication sh.a, me Pajtimtarin per Sherbimin Publik Telefonik te Levizshem, sipas dokumentit bashkengjitur ketij vendimi.
2. Plus Communication sh.a te publikoje ne faqen e tij te Internetit termat e pergjithshme te Kontratave Tip, te miratuara me kete vendim.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE

ANEKS 1
**TERMAT E PERGJITHSHEM TE KONTRATES (KONTRATA TIP) TE
SIPERMARRESIT PLUS COMMUNICATION SH.A., ME PAJTIMTARIN PER
SHERBIMIN PUBLIK TELEFONIK TE LEVIZSHEM**

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Bazuar në:

1. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”.
3. Ligjin nr. 9987, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
4. Autorizimim Individual të Operatorëve të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë – Plus Communication SH.A., lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me Vendimin Nr.745, datë 26.06.2009

Hartohen

Këto kushte të përgjithshme (“Kushtet e Përgjithshme”) do të rregullojnë marrëdhënien juridike midis Shoqërisë PLUS COMMUNICATION Sh.A. (më poshtë “PLUS”) dhe kërkuesit, qoftë ky individ, person fizik apo person juridik (më poshtë “Pajtimtari”), i cili dëshiron të përfitojë shërbime publike të telefonisë së lëvizshme që PLUS ofron nëpërmjet rrjetit të vet (më poshtë “Shërbimet”), në përputhje me autorizimet që i janë lëshuar për këtë qëllim nga autoritetet kompetente.

Këto Kushte të Përgjithshme së bashku me formularin për pajtim për në rrjetin e telefonisë së lëvizshme PLUS dhe tarifat e shërbimeve sipas programit tarifor të zgjedhur nga Pajtimtari përbëjnë “Kontratën” midis PLUS dhe Pajtimtarit.

PËRKUFIZIME

“PLUS COMMUNICATION SH.A” është shoqëri aksionare e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër K91811014B, me datë themelimi 10.06.2009, e cila ushtron aktivitetet në fushën e komunikimeve elektronike e njoftuar rregullisht në bazë të regjimit të autorizimit të përgjithshëm dhe është regjistruar në Regjistrin e Sipërmarrësve të botuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

“AKEP” është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

”**Autorizimi**” përfshin Autorizimin e Përgjithshëm dhe Autorizimin Individual lëshuar Operatorit Plus Communication nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (më poshtë “AKEP”) respektivisht me Vendimin Nr. 745, datë. 26.06.2009, i ndryshuar dhe Konfirmimin e Njoftimit datë 23.06.2009.

”**Afati fillestar i kontratës së pajtimit**” është afati kohor prej jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të Kontratës;

”**Pajtimtar**” është cilido përdorues fundor, qoftë ky individ, person fizik ose juridik që ka lidhur një kontratë me PLUS për përfitimin e shërbimeve të ofruara të sistemit të telefonisë së lëvizshme PLUS, të dhënat e të cilit gjenden në formularin për pajtim dhe të cilit i jepet e drejta të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.

”**Pajtimtar me parapagim**” (Përdorues fundor me parapagim) është pajtimtari i cili ka zgjedhur mënyrën me parapagim të pagesës për shërbimet që do përfitojë.

”**Përdorues fundor**” është një përdorues, i cili nuk ofron rrjete komunikimesh publike ose shërbime komunikimesh elektronike, të disponueshme për publikun.

”**Pajisje fundore**” e Pajtimtarit është çdo lloj pajisje e lidhur në pikën fundore të rrjetit PLUS, e miratuar nga autoritetet përkatëse kompetente e cila përpunon me karakteristikat e rrjetit PLUS, dhe që shërben për transmetimin, marrjen dhe përpunimin e komunikimeve nga pika në pikë.

”**Karta SIM**” është karta që përmban mikroprocesorin e nevojshëm dhe të dhëna të lidhjes që bën të mundur lidhjen e pajisjes fundore të Pajtimtarit me rrjetin PLUS. Karta SIM duke u vendosur brenda pajisjes fundore nëpërmjet një foleje të posaçme, bën të mundur komunikimin dhe përdorimin e telefonisë së lëvizshme celulare të aktivizuar. Karta SIM identifikohet nga numri serial SIM.

”**Lidhja**” është lidhja e pajisjes fundore me sistemin.

“**Lista e çmimeve**” është lista e vlerave monetare të përcaktuara (tarifat e shërbimit) që paguhen nga pajtimtarët për përdorimin e shërbimeve të licensuara të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të tjera që kanë lidhje me këtë sistem, të vendosura nga PLUS në bazë të ligjit.

“**Numër Aksesit**” është një seri alfa-numerike e përcaktuar në planin e numeracionit, që shërben për adresim në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. Numri i aksesit është një numër unik i cili i kombinuar me numrin serial të kartës SIM identifikon një pajtimtar në rrjetet GSM ose 3G.

“**Ndërprerje/Bllokim i shërbimit**” është heqja e përkohshme e të drejtës së Pajtimtarit për të përdorur të gjitha ose një pjesë të shërbimeve të PLUS por edhe e numrit që i është dhënë atij, që mund t’i rikthehet përsëri në kushte të caktuara.

“**Sistem**” është sistemi i telefonisë së lëvizshme të komunikimeve elektronike i standartit GSM i instaluar në PLUS në përputhje me Autorizimin për të ofruar shërbime publike të telefonisë së lëvizshme të komunikimeve elektronike, i cili vihet në punë sipas kushteve të autorizimit të dhënë Shoqërisë PLUS.

“**Shërbime**” janë shërbimet bazë të komunikimit me zë dhe të transmetimit të të dhënave të cilat ofrohen nga PLUS në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me kushtet e Sistemit të Integruar të Komunikimeve Elektronike sipas Teknologjisë së Lëvizshme të autorizuar në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe legjisllacionit shqiptar.

“**Shërbim me vlerë të shtuar**”, është shërbimi që ofron informacion, përkundrejt pagesës, nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit.

“**Shkëputje**” është heqja përfundimtare e së drejtës së Pajtimtarit për të përdorur të gjitha shërbimet PLUS sëbashku me numrin e tij të aksesit.

“**Shërbimet Roaming**” janë shërbime të cilat i mundësojnë Pajtimtarit të përdorë shërbimet telefonike të komunikimit me zë dhe transmetimit të të dhënave edhe në vende jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me të cilat PLUS ka lidhur marrëveshje.

1. LIDHJA E KONTRATËS/ PRANIMI I KËRKESËS PËR PAJTIM

- 1.1. Çdo kërkues, qoftë ky individ, person fizik apo juridik, ka të drejtë që brenda një afati të arsyeshëm nga koha e paraqitjes dhe pranimit të kërkesës së tij për pajtim dhe rradhës së kërkesave, të përdorë lirisht dhe pa dallim shërbimet e komunikimeve elektronike që ofrohen nga PLUS në përputhje me kushtet e Autorizimit. PLUS ka të drejtë që herë pas here të marrë masa ligjore objektive me qëllim mbrojtjen nga rreziku i borxheve të këqija. Këto masa do të merren në përpjestim të drejtë me rrezikun.
- 1.2. PLUS në bazë të përcaktimeve dhe kushteve të Autorizimit, Kushteve të Përgjithshme dhe formularit për pajtim, është i detyruar të japë vetëm ato shërbime dhe vetëm në ato zona mbulimi të përcaktuara dhe miratuara nga organet kompetente. Pajtimtari nuk ka asnjë detyrim financiar pa u kryer nënshkrimi i Kontratës nga të dy palët.
- 1.3. PLUS duhet t'i kthejë përgjigje të shpejtë kërkesës për pajtim. PLUS ka të drejtë që, gjatë fazës parakontraktore, të kërkojë të dhëna për adresën dhe identitetin e pajtimtarit të ardhshëm, si fotokopje të letërnjoftimit, pasaportës për jashtë shtetit, të librezave të telefonit ose të energjisë elektrike ose dokumentave të tjera, kur ai është individ ose person fizik dhe dokumenta që provojnë identitetin e tij, kur ai është person juridik dhe mund të kërkojë gjithashtu informacion për deklarata tatimore ose dokumente të tjera të ngjashme me të, në mënyrë që të verifikojë aftësinë paguese të pajtimtarit dhe të marrë vendime për të kredituar ose jo shërbime ose të veprojë, sipas rastit, duke shmangur ose konstatuar aktet e paligjshme.
- 1.4. Pajtimtari nuk ka detyrim të paguajë asnjë lloj shume pa u bërë lidhja dhe nënshkrimi i kontratës nga të dy palët.

2. LIDHJA ME SISTEMIN/ DHËNIA E SHËRBIMEVE

- 2.1. PLUS, në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe pas aprovimit të dokumentacionit të Pajtimtarit do të kryejë aktivizimin e kartës SIM dhe ofrimin shërbimeve Pajtimtarit.
- 2.2. PLUS do të pajisë Pajtimtarin me kartën SIM nëpërmjet të cilës mundësohet përdorimi i shërbimeve të ofruara. PLUS do të njoftojë Pajtimtarin për Numrin përkatës të Aksesit si dhe do t'i japë atij udhëzimin përkatës për përdorimin e shërbimeve të ofruara.
- 2.3. Me aktivizimin e pjesshëm ose të plotë të kartës SIM, Pajtimtari ka të drejtë të përdorë informacionin që ajo ka në përputhje me qëllimin e përmbushjes së Kontratës. Nëpërmjet këtij dokumenti pranohet shprehimisht se Pajtimtari nuk fiton të drejtën as mbi kartën SIM dhe as të drejtat mbi të dhënat që përmban ajo. PLUS mban përgjegjësi vetëm për zëvendësimin e kartave të dëmtuara, me përjashtim të rasteve kur këto dëmtime vijnë si rrjedhojë e veprimeve apo mosveprimeve të pakujdesshme ose të vullnetshme të Pajtimtarit.
- 2.4. Në përputhje me parimin e paanshmërisë teknologjike, dhe duke qënë se karta SIM shoqërohet gjithmonë me një numër serial dhe me një ose më shumë numra aksesi, të gjitha komunikimet e kryera nëpërmjet kartës SIM do të konsiderohen si të kryera nga vetë Pajtimtari apo me pëlqimin/miratimin e tij. Si rrjedhim, Pajtimtari do të jetë përgjegjës sipas Kushteve të Përgjithshme të kësaj Kontrate dhe legjislacionit në fuqi.
- 2.5. Pajtimtari përgjigjet civilisht ose penalisht për përdorimin e kartës SIM në kundërshtim me kushtet e Kontratës dhe me ligjin dhe është i detyruar që në raste humbje, vjedhje, shkatërrimi tërësor ose të pjesshëm të kartës, përdorim të paautorizuar nga të tretët, të dëmshpërblejë PLUS për dëmet e shkaktuara.

- 2.6. Në të gjitha rastet e mësipërme dhe në rastin e dëmtimit të kartës SIM për arsye që nuk varen nga PLUS, Pajtimtari detyrohet të njoftojë menjëherë PLUS dhe t'i kthejë kartën SIM, duke paraqitur numrin e aksesit. PLUS do të procedojë me zëvendësimin e kartës SIM dhe sipas rastit do të kryejë rilidhjen e Pajtimtarit përkundrejt çmimit të zëvendësimit të kartës SIM në përputhje me listën e çmimeve në fuqi në kohën e rilidhjes.
- 2.7. Pajtimtari ka të drejtë ekskluzive të përdorë numrin e aksesit sipas kësaj Kontrate dhe legjislacionit në fuqi. Me përfundimin e Kontratës për çfarëdo lloj arsye, e drejta e ripërdorimit të numrit të aksesit të Pajtimtarit i kalon automatikisht PLUS bashkë me të drejtat e tjera të përdorimit që lidhen me të. Me përfundimin e kontratës së një numri të bartur, operatori dhënë fillëstar ka të gjitha të drejtat për ripërdorimin e numrit. PLUS ka të drejtë të kalojë të drejtat e përdorimit të numrit të aksesit, kur kjo është e nevojshme për arsye që kanë lidhje me funksionimin e pandërprerë të sistemit, për arsye teknike ose kur e kërkon ligji ose nevoja e organeve shtetërore në bazë të legjislacionit në fuqi.
- 2.8. Pajtimtari gëzon të gjitha të drejtat e dhëna nga legjislacioni dhe kuadri ligjor rregullator në fuqi, përfshirë të drejtën e portabilitetit të numrit të dhënë nga PLUS në një sipërmarrës tjetër të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

3. TARIFAT

- 3.1. Për çdo shërbim të përdorur të PLUS, Pajtimtari do të faturohet në përputhje me listën e çmimeve që është në fuqi sipas rastit dhe tarifave të PLUS të rena dakort në kontratë në kohën e nënshkrimit të Kontratës apo modifikimeve të nënshkruara të saj.
- 3.2. Faturat duhet të kenë informacionin e mjaftueshëm në mënyrë të tillë që Pajtimtari të llogarisë shumën e duhur që do t'i faturohet atij për të gjitha llojet e shërbimeve të ofruara, duke përfshirë kohën e çdo thirrjeje në rastet kur çmimet për shërbimet ndryshojnë sipas përdorimit të tyre.
- 3.3. PLUS dhe Pajtimtari bien dakort për mënyrën e pagesës së faturave rast pas rasti. Kur pajtimi mbaron pas kalimit të afatit fillestar prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, ose kur shërbime të caktuara nuk ofrohen më ose nuk kerkohen më nga Pajtimtari, garancitë e vendosura dhe të rena dakort midis PLUS dhe Pajtimtarit, do t'i kthehen atij, pa interes, me kerkese të Pajtimtarit, përveç rasteve kur Pajtimtari ka detyrime të pashlyera ndaj PLUS. Në rastin kur Pajtimtari ka detyrime ato do të paguhën duke i mbajtur nga garancia e dhënë. Në rast se detyrimet e pajtimtarit ndaj PLUS nuk mbulohen me garancinë e pajtimtarit, PLUS ka të drejtë të ndjeke procedurat në fuqi për të mbledhur detyrimet e pashlyera nga Pajtimtari.
- 3.4. Shërbimet dhe tarifat e tyre, të ofruara nga PLUS dhe të pranuar nga Pajtimtari, do të bashkëngjiten në formë Aneksi në këtë Kontratë dhe janë pjesë integrale e Kontratës së nënshkruar midis Palëve.
- 3.5. Tarifat dhe shërbimet janë objekt ndryshimi, të cilat vendosen dhe publikohen sipas përcaktimeve të Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator në RSH.
- 3.6. Ndryshimi i shërbimeve të kontraktuara (reduktimi i njeanshem nga PLUS i numrit të shërbimeve dhe/ose i cilesise se tyre) dhe rritja e tarifës të një apo me shume shërbimeve mbi nivelin e dhene ne Aneks ne kohen e nenshkrimit te kontrates, konsiderohet modifikim i kushteve te kontrates dhe PLUS ka detyrimin te njoftoje me shkrim pajtimtarin te pakten 30 (tridhjetë) dite para hyrjes se tyre ne fuqi.
- 3.7. Njoftimi për rritjen e tarifave do të bëhet brenda dhe jo më vonë se 30 ditë përpara datës së propozuar për zbatimin e tyre. Uljet e tarifave mund të hyjnë në fuqi menjëherë.
- 3.8. PLUS ruan të drejtën për të përcaktuar kushtet dhe afatet për pjesmarrjen e Pajtimtarëve në ofertat promovionale.

4. MENYRA E PAGESES

- 4.1. PLUS do të faturojë shërbime në çdo muaj. Pajtimtari është i detyruar të paguajë brenda afatit të pagesës së treguar në faturë sipas mënyrës së kërkuar nga PLUS përfshirë, por pa u kufizuar në, pagesë me para në dorë, me pagesë bankare, me kartë krediti ose mënyra të tjera pagese. Afati i pagesës për Pajtimtarët me paspagim, nuk do të jetë më vonë se data 28 e muajit pasardhës. Fatura, lëshohet dhe i dorëzohet Pajtimtarit në adresën e specifikuar nga Pajtimtari në formularin për pajtim, me postë ose dorazi, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara afatit të pagesës së saj që konsiderohet si datë e marrjes dijeni nga Pajtimtari për faturën mujore përkatëse e të lëshuar nga PLUS. Pajtimtari heq dorë shprehimisht nga kundërshtimi i shumës që tregon fatura mujore, në rast se nuk ka bërë kundërshtim me shkresë dërguar PLUS brenda afatit të pagesës së treguar në faturë.
 - 4.1.1. Pajtimtari detyrohet t'i paguajë PLUS, në formë parapagimi, ose pas dhënies së shërbimeve, tarifat e mëposhtme:
 - i. Tarifën e lidhjes me rrjetin (parapagim)
 - ii. Tarifën mujore fikse (paspagim)
 - iii. Tarifën për të gjitha bisedat e komunikimet telefonike si dhe tarifat për shërbimet shtesë të dhëna nga PLUS, të cilat parashikohen me hollësi në fletën e udhëzimeve në përputhje me kontratën me Pajtimtarin për mënyrën e dhënies së shërbimeve, sipas listës së çmimeve në fuqi.
 - 4.2. Nëse Pajtimtari nuk shlyen faturën brenda afatit të pagesës së treguar në faturë
 - 4.2.1. PLUS ka të drejtë të marrë masa kufizuese sipas përcaktimeve në nenin 9;
 - 4.2.2. Pajtimtari do të paguajë kamatën në masën 0,5% të faturës mujore të papaguar, për çdo ditë vonesë në pagim nga afati i pagesës së përcaktuar në faturë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlera e kamatës në asnjë rast nuk do të jetë më e madhe se vlera e faturës së papaguar.
 - 4.2.3. Për shumat e mësipërme Pajtimtari do të paguajë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tarifat/taksat e telefonisë së lëvizshme sipas legjislacionit në fuqi.
 - 4.3. Kur pagesa e faturave kryhet nëpërmjet debitimit të drejtpërdrejtë të llogarisë bankare, PLUS nuk mban përgjegjësi për datën e kryerjes së veprimeve nga banka përkatëse.
 - 4.4. PLUS do t'i lëshojë dhe dërgojë pa pagesë Pajtimtarit faturën bazë që përfshin:
 - i. Tarifën mujore fikse (nëse ka);
 - ii. Tarifat për njësi shërbimi të përdorura nga Pajtimtari;
 - iii. Llogaritjen e detyrimeve për t'u paguar;
 - iv. Detyrime fiskale;
 - v. Adresa dhe afatet e shlyerjes së faturës ;
 - vi. Mënyra e pagesës: me para në dorë, me kartë krediti ose mënyrë tjetër ;
 - vii. Sanksione në raste mosshlyerje të detyrimeve (kamatë – vonesë, ndërprerje të shërbimeve, kufizime të shërbimeve, thirrje vetëm hyrëse dhe thirrje dalëse vetëm për numrat pa pagesë, zgjidhje e kontratës nga PLUS) ;

- viii. Trafikun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, i detajuar sipas numrave të thirrur dhe kohëzgjatjes së thirrjes (pervec rasteve kur nuk kërkohet nga pajtimtari) ;
- ix. Detyrimet për pagesë për çdo komunikim të kryer;
- x. numër kontakti të PLUS për Kujdes ndaj Klientit për informacion për faturën (thirrjet drejt këtij numri janë pa pagesë ose me kosto të ulët).

5. KUFIRI MAKSIMAL I KREDITIT

- 5.1. PLUS ka të drejtë të vendosë kufijtë maksimalë të kreditit për çdo Pajtimtar dhe t'i ndryshojë ato në rastin kur Pajtimtari kalon nga një plan tarifor në një plan tjetër tarifor. Kur Pajtimtari e kalon kufirin e kreditit PLUS ka të drejtë:
 - 5.1.1. Të ndërpresë/blokojë shërbimet e dhëna, dhe
 - 5.1.2. Të kërkojë dhe lëshojë faturë për pagimin e menjëhershëm të detyrimit dhe pagesa do të pasqyrohet në faturën e muajit në vazhdim, ose
 - 5.1.3. Të kërkojë nga Pajtimtari pagimin e menjëhershëm të një garancie deri në dyfishin e vlerës që ka fatura në atë çast, si dhe të ndërpresë dhënien e të gjitha shërbimeve kur Pajtimtari nuk përmbush detyrimet e mësipërme. Kufiri maksimal i kredisë për shërbimet e faturuara dhe të pafaturuara është shuma totale e garancisë së dhënë nga Pajtimtari.
- 5.2. Pajtimtari, me qëllim kontrollin e shpenzimeve, ka të drejtë t'i kërkojë PLUS që të vendosë kufij maksimalë të kredisë.

6. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PLUS

- 6.1. PLUS detyrohet të njoftojë Pajtimtarin përpara nënshkrimit të formularit për pajtim për Kushtet e Përgjithshme dhe kushtet e lidhjes dhe përdorimit të shërbimeve të përcaktuara nga PLUS, afatin e Kontratës për dhënien e shërbimit të sistemit dhe mënyrën e zgjidhjes së saj, rregullat e përdorimit të kartës SIM, tarifën, veçoritë e sistemit, cilësinë e shërbimeve dhe zonën e mbulimit me shërbime.
- 6.2. PLUS përveç detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin dhe kuadrin ligjor rregullator në fuqi dhe përcaktimet në pjesë të tjera të kësaj Kontrate, ka gjithashtu dhe detyrimet e mëposhtme:
 - 6.2.1. Të hartojë Kontratën dhe gjithë elementët e saj, në format të printuar, lehtësisht të lexueshëm dhe të kuptueshëm.
 - 6.2.2. Me kërkesën e pajtimtarit, vë në dispozicion të tij Kontratën në format të përshtatshëm për të plotësuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara shikimi.
 - 6.2.3. T'i ofrojë Pajtimtarit një shpjegim të hollësishëm të të gjitha kushteve të përdorimit dhe Kontratës përpara nënshkrimit të saj.
 - 6.2.4. T'i japë Pajtimtarit informacion të detajuar për programet tarifore që mund të zgjedhë Pajtimtari, duke i dhënë mundësinë e krahasimit midis tyre, përfshirë:
 - 6.2.4.1. Informacion të plotë dhe të qartë, për paketat tarifore dhe ofertat promovionale apo speciale si zbritjet e tarifave, trafik i pakufizuar, kohën e kryerjes së thirrjeve, duke specifikuar midis të tjerave çfarë përfshihet në paketë/ofertë dhe çfarë nuk përfshihet në to, afatet kohore të ofertave dhe efektet e tejkalimit të tyre, përfshirë tarifën e aplikuar

- 6.2.4.2. Sistemin tarifor të aplikuar për shërbimet si koha minimale e tarifimit, mënyra e tarifimit pas kohës minimale, njësia e matjes për tarifimin (p.sh. sekonda, intervale kohore, M/byte etj), ndryshimi i tarifës në përputhje me kohëzgjatjen, koha e kryerjes së thirrjes (peak/off peak) dhe intervalet përkatëse kohore të tyre, etj.
- 6.2.4.3. Shërbimet shtesë të përfshira në paketën e zgjedhur.
- 6.2.4.4. Informacion për cilësinë e shërbimeve të ofruara/zgjedhura.
- 6.2.5. Të mos refuzojë lidhjen në rrjet të pajisjeve fundore që janë në përputhje me Ligjin nr. 9918 dhe aktet nën-ligjore të tij.
- 6.2.6. Të aplikojë rritjen e tarifës së një apo më shumë shërbimeve të zgjedhura nga Pajtimtari në kontratë, vetëm pas ezaurimit të procesit të njoftimit të Pajtimtarit nga PLUS të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre në bazë të nenit 15 të Kontratës.
- 6.2.7. Të aplikojë automatikisht dhe pa njoftim uljen e tarifës së një apo më shumë shërbimeve të zgjedhura nga Pajtimtari në kontratë.
- 6.2.8. Të mos vendosë detyrim financiar për rilidhje në rrjet nëse ndërpreja e shërbimit është kryer për shkak të gabimeve të PLUS.
- 6.2.9. Për kufizimet apo për ndërprerjet e shërbimit, të cilat zgjasin më shumë se 30 minuta, PLUS ka detyrimin të vërë në dijeni AKEP-in dhe Pajtimtarët. Ky njoftim të bëhet:
- i. të paktën 48 orë më parë, në rast të një përmirësimi, modernizimi ose mirëmbajtjeje të rrjetit;
 - ii. sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë, pas ndodhjes së kufizimit apo ndërprerjes së shkaktuar nga defekte apo dëmtime të rrjetit.
- 6.3. Në rastet kur PLUS nuk u vë në dispozicion Pajtimtarëve shërbimet e saj 24 orë në ditë për 365 ditë radhazi në vit (me përjashtim të ndërprerjes për riparime të zakonshme për mirëmbajtjen e rrjetit dhe rasteve të forcës madhore të parashikura në Nenin 14) për faj të PLUS, PLUS do t'i faturojë Pajtimtarit tarifën fikse mujore të pajtimit përpjestimisht me kohën e shfrytëzuar efektivisht prej tij dhe t'ia zbrësë atë nga shuma përkatëse mujore.
- 6.4. PLUS detyrohet të mbajë një dosje të të gjitha ankesave dhe kërkesave të Pajtimtarit e cila tregojnë nëse ato janë zgjidhur dhe kohën që kërkohet për këtë. Dosja ruhet për një periudhë prej të paktën 2 (dy) vitesh. PLUS detyrohet të ruajë për një afat së paku 2 (dy) vjeçar kopjen e faturave dhe t'u japë sqarime pajtimtarëve që kanë ankesa për faturimet.
- 6.5. Në përputhje me kërkesën e Pajtimtarit, PLUS do të mundësojë bartjen e numrit (portabiliteti i numrit) në përputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregullator në fuqi.

7. TE DREJTA DHE DETYRIME TE PAJTIMTARIT PER PERDORIMIN E SHERBIMEVE

- 7.1. Mënyra e përdorimit të shërbimeve nga Pajtimtari bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përveç sa më sipër, Pajtimtari detyrohet:
- 7.1.1. të mos përdorë ose të mos lejojë persona të tretë të përdorin shërbimet e dhëna për qëllime që bien në kundërshtim me moralin ose ligjin.
 - 7.1.2. të mos e përdorë kartën SIM të PLUS për ri-rrugëzim të thirrjeve apo komunikimeve telefonike të gjeneruara nga palë të treta duke përdorur rrjetin PLUS në drejtim të pajtimtarëve të tjerë PLUS, përveçse me miratimin paraprak me shkrim të PLUS.
 - 7.1.3. t'i përmbahet udhëzimeve të PLUS për mënyrën e përdorimit të shërbimit dhe pajisjeve fundore nga pajtimtari ose për çështje të tjera.

- 7.1.4. t'i japë PLUS të gjithë informacionin e nevojshëm për ofrimin e shërbimit sa herë i kërkohet nga PLUS.
- 7.1.5. t'i përmbahet udhëzimeve të PLUS për mënyrën e përdorimit të shërbimit dhe pajisjeve fundore nga pajtimtari ose për çështje të tjera.
- 7.1.6. Pajtimtari ka detyrimin të përdorë shërbimet në përputhje me ligjin si dhe manualin ose udhëzimet përkatëse.
- 7.1.7. Pajtimtari ka detyrimin të përdorë pajisje fundore të miratuara nga autoritetet përkatëse kompetente e cila përputhet me karakteristikat e rrjetit PLUS dhe me legjislacionin në fuqi.
- 7.1.8. Pajtimtari me parapagim gëzon të drejta dhe ka detyrime që janë jo më pak të favorshme se ato të pajtimtarëve me paspagim për shërbime të të njëjtit lloj. Për pajtimtarët me parapagim, kushtet e veçanta të mënyrës së përdorimit të shërbimeve, përfshirë kreditimin nëpërmjet kartave rimbushëse apo afatet e përdorimit të tyre, paraqiten në udhëzuesin shoqëruar të kartave SIM me parapagim, kartave rimbushëse shoqëruese dhe informacioneve të tjera të publikuara nga PLUS.
- 7.2. Pajtimtari ka të drejtë të zgjedhë, ndryshojë në çdo kohë shërbimet e zgjedhura nëpërmjet një njoftimi/kërkese me shkrim apo me ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar nga PLUS, duke respektuar kushtet e kontratës si dhe:
- 7.2.1. Pajtimtari ka të drejtë të zgjedhë ose jo shërbimet me vlerë të shtuar, të cilat ofrohen nga PLUS në përputhje me Autorizimin e lëshuar nga AKEP si dhe me legjislacionin në fuqi.
- 7.2.2. Pajtimtari do të përdorë shërbimet me vlerë të shtuar "siç janë" dhe nuk mund t'i ndryshojë në asnjë mënyrë ato.
- 7.2.3. Pajtimtari merr përsipër, pranon dhe garanton se ai do t'i përdorë shërbimet me vlerë të shtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.
- 7.2.4. Me qëllim mbrojtjen e të miturve, ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar nga PLUS dhe/ose nga ofrues të tjerë të këtyre shërbimeve me të cilët PLUS ka lidhur marrëveshje, do të kryhet në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- 7.2.5. Pajtimtari ka të drejtë të marrë pjesë ose jo në lojrat promovionale të cilat ofrohen dhe zhvillohen nga PLUS në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara nga PLUS. Pajtimtari në mënyrë të veçantë njoftohet nga PLUS, se ai para pjesëmarrjes në lojë duhet të lexojë dhe pranojë/konfirmojë rregullat e plota të lojës të publikuara përpara organizimit të lojës nga PLUS.
- 7.3. Pajtimtari ka të drejtën të kërkojë me shkrim zgjidhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme vetëm për shkaqet e përcaktuara në nenin 10 të Kontratës.
- 7.4. Pajtimtari ka të drejtë të informohet me shkrim nga PLUS për të gjitha ndryshimet e propozuara në kushtet e Kontratës, brenda një periudhe kohore prej jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve

8. NDERPRERJA/SHKEPUTJA

- 8.1. PLUS vë në dispozicion shërbimet e saj 24 orë në ditë për 365 ditë radhazi në vit, me përjashtim të ndërprerjes për një afat kohor prej jo më shumë se 6 (gjashtë) orë në vit, i programuar në mënyrë të tillë që të sjellë sa më pak shqetësime te pajtimtarët gjatë kohëzgjatjes së ndërprerjes së shërbimeve ku nevojiten riparime për mirëmbajtjen e rrjetit duke i lajmëruar ata publikisht.

- 8.2. PLUS mund të ndërpresë dhënien e shërbimeve ose kur e shikon të arsyeshme të shkëpusë lidhjen e Kartës SIM të Pajtimtarit nga rrjeti i PLUS, kur një gjë e tillë shkaktohet si pasojë e defekteve në sistem, ose ndryshimeve, përmirësimeve, mirëmbajtjes së infrastrukturës ose riparimeve të tjera të nevojshme, duke marrë masa për të kufizuar çrregullimet e mundshme në rrjet.
- 8.3. Nëse Pajtimtari nuk përmbush kushtet e Kontratës apo nuk kryen pagesat, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, PLUS ka të drejtë dhe është e detyruar të dërgojë një njoftim me shkrim ose me SMS/telefonatë brenda një intervali kohor 15 (pesëmbëdhjetë) ditor, me qëllim që Pajtimtari të plotësojë detyrimet kontraktore dhe paralajmërimin për masat kufizuese që mund të ndërmarrë PLUS.
- 8.4. Në rast se Pajtimtari nuk do të përmbushë detyrimet e tij kontraktore brenda afatit të përcaktuar nga PLUS, atëherë kjo e fundit ka të drejtë të kufizojë, të ndërpresë përkohësisht apo edhe përfundimisht ofrimin e Shërbimeve. Deri në ndërprerjen përfundimtare të ofrimit të Shërbimeve, Pajtimtari është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet e lindura për të gjitha shërbimet e telekomunikacionit të përfituara por të papaguara deri në atë moment. Në rast mosshlyerje të detyrimeve të përcaktuara në faturë brenda afatit të përcaktuar në faturë, PLUS do të njoftojë Pajtimtarin me mesazh të shkurtër (SMS) ose telefonatë të kryejë pagesën brenda një afati shtesë prej 5 (pesë) ditësh nga dita e kërimit. Pas përfundimit të këtij afati, PLUS ruan të drejtën të ndërpresë përfundimisht shërbimet e ofruara kundrejt Pajtimtarit dhe shkëpusë lidhjen në rast mospërmbushje të detyrimeve financiare përtej afateve të caktuara nga PLUS.
- 8.5. PLUS nuk është e detyruar të njoftojë paraprakisht pajtimtarët për masat e marra në rast se shkelja e evidentuar e Kontratës:
- a. shkakton një kërcënim serioz të rendit e sigurisë publike, shëndetit dhe mjedisit;
 - b. shkakton një dëmtim serioz fizik, material ose funksional të rrjetit.
- 8.6. PLUS ka të drejtë të kufizojë pjesërisht aksesin, vetëm për ato shërbime që Pajtimtari ka shkelur kushtet e Kontratës, përveç rasteve kur Pajtimtari abuzon, ose në mënyrë të përsëritur kryen me vonesë pagesat ose nuk paguan faturat.
- 8.7. PLUS i ndalohet të kufizojë aksesin për përdorimin e numrave të emergjencës përpara ndërprerjes përfundimtare të shërbimit ose zgjidhjes së Kontratës.
- 8.8. PLUS ka të drejtë të pezullojë shërbimet në rast se kartat SIM apo shërbimet e PLUS përdoren për qëllime të tjera nga ato për të cilat këto shërbime i ofrohen Pajtimtarit dhe me qëllim përfitimin nga rrjeti i PLUS pa pëlqimin e saj, si:
- 8.8.1. për ndërmjetësimin dhe/ose transferimin e të dhënave dhe/ose telefonatave përfshirë por pa u kufizuar në transferimin e thirrjeve kombëtare/ndërkombëtare në rrjetin e PLUS dhe/ose rrjeteve të tjera;
 - 8.8.2. për ridrejtimin me pagesë të trafikut të palëve të treta përmes pajtimit në shërbimet e PLUS;
 - 8.8.3. për të fshehur dhe/ose modifikuar identitetin e palës thirrëse për këto qëllime;
- 8.9. PLUS mund që me anë të faturës së dërguar në adresën e fundit të njohur të pajtimtarit, të mbulojë shpenzimet që ka kryer për përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga Pajtimtari duke përfshirë, por pa u kufizuar në, shpenzimet e bëra nga PLUS për mos dhënien e informacionit të saktë të kërkuar prej Pajtimtarit.

- 8.10. PLUS në varësi të rrethanave në kohën e shkëputjes ose të rilidhjes mund të vendosë tarifa për shkëputjen dhe rilidhjen e kartës SIM dhe/ose numrit të aksesit të Pajtimtarit sipas legjislacionit dhe çmimeve në fuqi.
- 8.11. Pajtimtari ka të drejtë të kundërshtojë vendimet apo veprimet e PLUS në lidhje me aksesin apo ofrimin e shërbimeve kur ato bien ndesh me kushtet e Kontratës. Kundërshtimet sipas këtij paragrafi duhet të bëhen me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit apo veprimit të kryer nga PLUS. PLUS vendos për ankimimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e tij dhe njoftimi me shkrim i Pajtimtarit. Pajtimtari ka të drejtë që, në përputhje me përcaktimet në Kontratë për zgjidhjen e mosmarrvëshjeve, të ankohet në gjykatë për vendimin e marrë nga PLUS.

9. ZGJIDHJA E KONTRATES NGA PLUS

- 9.1. PLUS mund të zgjidhë menjëherë Kontratën, pa detyrim për dëmshpërblim duke njoftuar me shkrim Pajtimtarin kur:
- 9.1.1. Pajtimtari nuk përmbush çdonjërin prej detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë ndërmjet Pajtimtarit dhe PLUS;
- 9.1.2. Pajtimtari nuk paguan menjëherë detyrimet pas kalimit të afatit prej 2 (dy) muajsh nga ndërprerja e përkohëshme ose bllokimi i rrjetit;
- 9.1.3. Pajtimtari ndryshon emrin, statusin ligjor, falimenton, likujdohet, shpërbëhet, vendoset nën administrim të detyruar ose kërkohet ndalimi i pagesave ose në raste të tjera të ngjashme, pavarësisht nëse është paraqitur një kërkesë e tillë, kur Pajtimtari është në gjëndje paafësie paguese ose nuk ka mundësi të paguajë kreditorët;
- 9.1.4. Pajtimtari kryen ose lejon kryerjen e veprimeve që mund të rrezikojnë funksionin normal të rrjetit dhe dhënien e shërbimeve;
- 9.1.5. Autorizimi i PLUS revokohet, i mbaron afati, anulohet ose ndryshohet tërësisht ose pjesërisht për arsye të ndryshme;
- 9.1.6. Përveç sa më sipër, në rastin e kontratës me afat të pacaktuar, PLUS mund të zgjidhë Kontratën duke njoftuar 30 (tridhjetë) ditë përpara.

10. ZGJIDHJA E KONTRATES NGA PAJTIMTARI

- 10.1. Pajtimtari mund të kërkojë zgjidhjen e Kontratës për shkaqe të arsyeshme, duke njoftuar me shkrim paraprakisht PLUS. Pajtimtari bie shprehimisht dakort se shkak i arsyeshëm për zgjidhjen e Kontratës në kuptim të këtij neni është rritja e tarifave të shërbimeve telefonike në një përqindje më të lartë se sa përqindja vjetore e inflacionit të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në muajin Dhjetor të çdo viti që i paraprin rritjes. Pajtimtari mund të ushtrojë të drejtën e tij për zgjidhjen e Kontratës duke përdorur këtë shkak brenda 2 (dy) muajve nga njoftimi për rritjen e tarifave, përndryshe Pajtimtari do të konsiderohet se e ka pranuar rritjen e tyre.
- 10.2. Pas mbarimit të Afatit Fillestar të Kontratës, Pajtimtari mund ta zgjidhë Kontratën për çfarëdolloj shkak me anë të një njoftimi paraprak 30 (tridhjetë) ditor me shkrim drejtuar PLUS. Zgjidhja e Kontratës do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga PLUS.
- 10.3. Pajtimtari ka të drejtë të zgjidhë Kontratën me efekt të menjëhershëm dhe pa kosto shtesë, në rastet kur nuk është dakort me ndryshimin e kushteve të mëposhtme të Kontratës:

10.3.1. rritje të tarifës së një apo më shumë shërbimeve. Zgjidhja e Kontratës për këtë shkak mund të kryhet brenda 2 (dy) muajve nga njoftimi për rritjen e tarifave, përndryshe Pajtimtari do të konsiderohet se e ka pranuar rritjen e tyre.

10.3.2. përkeqësim të treguesve të cilësisë së shërbimit nga PLUS.

10.4. Zgjidhja e Kontratës sipas këtij neni nuk do të heqë detyrimet që Pajtimtari ka në bazë të kontratës së mëparshme.

11. PERFUNDIMI I KONTRATES

11.1. Pajtimtari bie shprehimisht dakort se me zgjidhjen e Kontratës sipas neneve 9 e 10 më sipër, PLUS do të shkëpusë lidhjen e numrit të aksesit dhe kartës SIM nga sistemi.

11.2. Pajtimtari njuh, pranon dhe garanton se do të shlyejë të gjitha detyrimet e lindura por të papaguara ndaj PLUS deri në momentin e shkëputjes dhe/ose zgjidhjes së Kontratës (kushdo qoftë më e vona në kohë) në përputhje me këtë Kontratë.

12. RUAJTJA E FSHEHTESISE SE KOMUNIKIMEVE TELEFONIKE DHE MBROJTJA E TE DHENAVE PERSONALE

12.1. PLUS detyrohet të sigurojë fshehtësinë ose karakterin e fshehtë të informacionit ose komunikimit të Pajtimtarit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12.2. PLUS nuk do të marrë, publikojë apo përdorë të dhënat apo komunikimet e Pajtimtarit të transmetuara nga rrjeti i tij i komunikimeve elektronike përveç rasteve kur ka detyrimin ta kryejë këtë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. KALIMI I KONTRATES/KALIMI I TE DREJTAVE

13.1. Pajtimtari nuk mund t'ia transferojë asnjë prej detyrimeve apo të drejtat që rrjedhin nga kjo Kontratë të tretëve, pa miratimin paraprak me shkrim të PLUS. PLUS nuk mund t'ia kalojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë të tretëve pa pëlqimin e Pajtimtarit, kur kjo mund të sjellë uljen e garancisë dhe cilësisë së shërbimeve.

14. FORCA MADHORE

14.1. Në rast se PLUS do të ndodhet në kushtet e forcës madhore, atëherë PLUS nuk mban përgjegjësi ndaj Pajtimtarit për mospërbushjen e detyrimeve të veta që lindin nga kjo kontratë gjatë kohëzgjatjes së forcës madhore. Pëzullimi i ekzekutimit të kontratës si pasojë e forcës madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës vazhdojnë efektet e forcës madhore. Konsiderohet si forcë madhore: lufta (e shpallur ose jo), konflikte të armatosura, greva, fatkeqësi natyrore, aktet terroriste, zbatimi i planeve të urgjencës kombëtare ose lokale dhe kufizime të ofrimit të shërbimeve të vendosura me ligj, aktet e autoriteteve shqiptare, të huaja ose ndërkombëtare me fuqi në Shqipëri apo çdo ngjarje apo rrethanë e ngjashme me sa më sipër. PLUS do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të përmbushur sa më mirë detyrimet e tij që rrjedhin nga kontrata.

15. TERESIA E MARREVESHJES DHE NDRYSHIMI I KUSHTEVE TE KONTRATES

15.1. Këto kushte të përgjithshme (Kushtet e Përgjithshme), së bashku me formularin për pajtim në rrjetin PLUS, shërbimet, dhe tarifatat sipas programit tarifor të zgjedhur nga Pajtimtari, dhe të nënshkruar prej të dy palëve, përbëjnë Kontratën midis PLUS dhe Pajtimtarit.

- 15.2. Përcaktimet e kushteve të përgjithshme të Kontratës dhe formulari i pajtimit janë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. _____, datë _____.2010.
- 15.3. Kushtet (Termat) e Përgjithshme të Kontratës mund të modifikohen apo zëvendësohen vetëm pas miratimit të ndryshimeve nga AKEP.
- 15.4. Për çdo modifikim apo zëvendësim të kushteve të përgjithshme të Kontratës, reduktimi të shërbimeve/cilësisë dhe rritje të tarifave të shërbimeve të zgjedhura nga pajtimtari, PLUS duhet:
- i. Të njoftojë Pajtimtarin me Kontratë nëpërmjet njoftimit individual (mund të jetë edhe me SMS apo me telefon nëpërmjet Call Center –Shërbimi i klientit) të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre. Njoftimi individual duhet të përfshijë adresën se ku janë publikuar ndryshimet/termat e reja, në rast se njoftimi nuk përmban detaje të mjaftueshme të ndryshimeve;
 - ii. Të njoftojë Pajtimtarët me parapagim, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre dhe ky njoftim duhet të bëhet për jo më pak se 3 (tre) ditë rresht ose nëpërmjet SMS/telefonate si në pikën "I" më sipër.
- 15.5. Ndryshimet e cituara në pikën 15.4, hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar nga AKEP (në rast se ato janë objekt miratimi nga AKEP) ose nga PLUS.
- 15.6. Për çdo ndryshim të shërbimeve/tarifave, PLUS duhet të njoftojë me shkrim Pajtimtarin të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre. Pajtimtari bie shprehimisht dakort se, përveçse kur i kundërshton ato me shkrim gjatë këtij afati 30 (tridhjetë) ditor, këto ndryshime do të hyjnë në fuqi automatikisht brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja prej tij e njoftimit sipas këtij paragrafi. Në çdo rast, Palët kanë të drejtë të nënshkruajnë amendamentet apo kontratën e re, në cdo kohë para apo pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve.
- 15.7. Në rast se Pajtimtari nuk është dakort me modifikimin e kushteve të Kontratës (përfshirë rritjen e tarifave) të cituar në pikën 10.3, Pajtimtari ka të drejtë të mos pranojë modifikimin/zëvendësimin e kontratës dhe ta zgjidhë Kontratën duke njoftuar me shkrim ose në zyrat e tij, para afatit të hyrjes në fuqi të tyre.
- 15.8. Kjo Kontratë është marrëveshja e plotë dhe e vetme ndërmjet PLUS dhe Pajtimtarit dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme verbale ose me shkrim midis Pajtimtarit dhe PLUS.
- 15.9. Ndryshimet apo zëvendësimi i Kontratës hyjnë në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët të një amendamenti apo të kontratës së re.

16. NJOFTIMI

- 16.1. Pajtimtari është i detyruar të njoftojë PLUS mbi të gjitha ndryshimet e të dhënave në formularin e kërkeses për pajtim. Pajtimtari pranon shprehimisht se, deri në njoftimin e ndryshimeve të tilla, të gjitha faturat ose dokumentet e tjera do të dërgohen në adresën e fundit të njoftuar PLUS me shkrim prej tij. Çdo njoftim i dërguar Pajtimtarit nga PLUS në përputhje me Kontratën do të vlerësohet sikur është marrë brenda 48 orëve nga data e dërgimit. Përsa i përket dërgimit të faturave nëpërmjet shërbimit postar ose shërbimeve të tjera, ato do të vlerësohen se janë marrë 10 (dhjetë) ditë nga data e lëshimit të tyre. Të gjitha afatet kohore të ditës të përcaktuara në këtë Kontratë janë të shprehura në ditë kalendarike.

17. LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 17.1. Kjo Kontratë është hartuar dhe rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

17.2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet PLUS dhe Pajtimtarit, kur nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim, do t'i paraqitet për zgjidhje gjykatës së vetme kompetente të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

18. VLEFSHMERIA/AFATI/ZBATIMI I DETYRUESHEM I KONTRATES

18.1. Kjo Kontratë lidhet për një afat fillestar prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar nga data e nënshkrimit të kontrates prej pajtimtarit 10 (dhjete) dite kalendarike para mbarimit të këtij afati, PLUS njofton Pajtimtarin, me shkrim ose me SMS/telefon, duke e informuar për mbarimin e afatit të testimit dhe të drejten e zgjidhjes së kontrates nga Pajtimtari pa detyrime shtese për fundimin e kontrates brenda këtij afati. Nëse Pajtimtari nuk ka njoftuar me shkrim PLUS se nuk dëshiron vazhdimin e kontrates përtej afatit 12 (dymbëdhjetë) muaj, kontrata kthehet në kontrate me afat të pacaktuar, por jo me shume se 24 (njëzetekatër) muaj nga data e nënshkrimit të saj.

18.2. Secila Palë ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të Kontratës, sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

18.3. Në rast së PLUS do të ofrojë për Pajtimtarët shërbime të tjera, apo programe tarifore/oferta specifike të tilla të cilat do të kenë si element të domosdoshëm të tyre detyrimin për të përdorur shërbimet për një periudhë të caktuar, atëherë rregullat e parashikuara nga këto kushte të përgjithshme do të zbatohen për atë sa nuk bien në kundërshtim me kushtet e veçanta që do të jenë karakteristike e marrëdhënies së posaçme midis PLUS dhe Pajtimtarit.

19. TITUJT

19.1. Titujt e kushteve të përgjithshme të Kontratës janë vetëm orientues dhe nuk ndikojnë në interpretimin e përmbajtjes së tyre.

20. NJOHJA E KUSHTEVE NGA PAJTIMTARI DHE DHENIA E GARANCIVE PREJ TIJ

20.1. Pajtimtari deklaron, pranon dhe garanton se është njohur plotësisht me afatet dhe kushtet e kësaj kontrate dhe pranon pa rezerva se Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së bashku me listën e çmimeve dhe tarifave të PLUS në fuqi, subjekt i ndryshimeve të herëpas'herëshme të PLUS, të kryera sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe kësaj Kontrate, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet Palëve për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit dhe faturimin përkatës të Pajtimtarit nga PLUS.

20.2. Kjo Kontratë hartohet në 2 (dy) kopje të njëvlefshme në gjuhën shqipe, nga të cilat 1 (një) kopje e mban PLUS dhe 1 (një) kopje i dorëzohet Pajtimtarit. Të dy kopjet nënshkruhen nga të dyja palët.

PAJTIMTARI: Deklaroj se mora dijeni të plotë dhe pranoj të gjitha kushtet e kësaj Kontrate Për dhe në emër të PLUS

firma-vula

.....

(emri-mbiemri i përfaqësuesit të autorizuar)

Pajtimtari

firma

.....

(emri-mbiemri)